



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Himarë, më 17 .01 . 2024

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike e-mail datë 05.01.2024.

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 05.01.2024 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:

1. Sa është vlera totale për ndihmë sociale që është dhënë për gratë/femrat e dhunuara?(
Te ndara sipas viteve 2020-2021-2022-2023);

Vlera totale e ndihmës sociale sipas ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, I ndryshuar ku për periudhën 2020-2021 janë trajtuar 2 raste me vlerën 3.000 lekë ndërsa për vitin 2022-2023 janë trajtuar 5 raste me vlerën 9.000 lekë në muaj për një periudhë 6 mujore.

2. Sa është buxheti i bashkisë tuaj për dhunën në familje? (Te ndara sipas viteve 2020-2021-2022-2023)?;

Buxheti i bashkisë për sektorin e dhunës në marrëdhënie familjare është i ndarë për vitin 2020-2021 është përcaktuar vlera 500.000 lekë me TVSh, ndërsa për vitet 2022-2023 është e 10.000.000 lekë.

3. Sa gra/femra të dhunuara kanë përfituar subvencionim të qirase/ bonus qiraje nga bashkia juaj? (Te ndara sipas viteve 2020-2021-2022-2023);

4. Sa gra/femra të dhunuara kanë përfituar kredi të buta për vitet 2020-2021-2022-2023? (sa kanë aplikuar dhe sa e kanë përfituar) ?

Bashkia Himarë nuk ka realizuar asnjë procedurë për subvencione apo kredi të butë për rastet e vikimave të dhunës në marrëdhënie familjare pasi deri më sot nuk është marrë asnjë nismë e tillë nga bashkia edhe pse e ka detyrim ligjor.

5. Cila është problematika më e madhe që keni ndeshur për të ndihmuar/mbeshtetur , gratë / femrat e dhunuara përgjatë këtyre viteve (2020-2023)?

Problematikat janë nga më të ndryshmet duke nisur nga mungesa e shërbimeve locale që ëyteti nuk ka si strehëza, shërbime ligjore falas dhe psikologjike. Duke vijuar nga mungesa e korrespondencës me gjykatën e cila nuk njofton në kohë për marrjen e venimeve për UM dhe UMM por I delegon ato në Bashkinë Vlorë, si dhe mo patja e një buxheti të mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e familjeve që janë në nevojë si pasojë e dhunës

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!